

**PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË TAKIMIT**  
**KËSHILLI KOMBËTAR PËR EKONOMI DHE INVESTIME (KKEI)**

**TAKIM I RREGULLT, I**

**Prishtinë, 20 shkurt 2024, 09:00 – 14:00**

Takimi u moderua nga Artan Mehmeti, Udhëheqës i Sekretariatit të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime. Në takim morën pjesë 29 anëtarë dhe rreth 30 vëzhgues. Pjesëmarrës ishin përfaqësues të shoqatave vendore të biznesit, të organizatave të huaja, dhe institucioneve shtetërore në Kosovë.

**Fjalët hyrëse**

**Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI**, në fjalën e tij hyrëse falenderon Kryeministrin Kurti, anëtarët e kabinetit qeveritar, stafin, institucionet vendore, përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare, odat dhe shoqatat përfaqësuese të biznesve vendore për pjesëmarrje në takimin e KKEI, dhe për bashkëpunimin e përgjithshëm për dialog publiko-privat. Ai tutje theksoi qëllimin e takimit, që shërben për të përafuar institucionet publike dhe sektorin privat, e që në këtë mënyrë të mundësojë fasilimin e reformave që kanë të bëjnë me klimën investive dhe mjedisin e të bërit biznes në Kosovë. Udhëheqësi i Sekretariatit shtoi se ky takim mundëson edhe diagnostikimin më të mirë të rekomandimeve, hartimin e politikave dhe reformave.

Z. Mehmeti poashtu informoi se si Sekretariati i KKEI mbështetet nga shteti zviceran përmes BERZH-it, e që punën ka filluar në tetor të vitit të 2023. Ai rikujtoi gjithashtu që në nëntor të vitit 2023, Sekretariati pati organizuar diskutime të ndara me sektorin privat, të strukturuar në 10 forume sektoriale.

**Kryeministri Albin Kurti, Kryesues, KKEI**, falenderon pjesëmarrësit për praninë në takim. Lidhur me fushën e investimeve të huaja dhe eksporteve, ai shpjegoi se të dyja janë dyfishuar gjatë tri viteve të fundit. Tutje, ai theksoi se raporti ndërmjet eksporteve dhe importeve është rritur nga 1 në 9 (sa ka qenë), në akoma më mirë se 1 me 6.

Ai theksoi se reformimi i kuadrit ligjor dhe rregullator, me qëllim të minimizimit të barrës administrative dhe krijimit të një mjedisi të barabartë për të gjithë, është prioritet i Qeverisë.

Në frymën e bumit të teknologjisë, Kryeministri shtoi se Kosova është pozicionuar si destinacion kryesor për shërbimet BPO (*business process outsourcing*), si një sektor që ka treguar rritje të konsiderueshme që nga viti 2015.

Lidhur me promovimin e energjisë përmes burimeve të ripërtrishme, ai përmendi përmbylljen e ankandit të parë për prodhim të energjisë solare për 100MW, ku 6 korporata serioze ndërkombetare ndodhen në garë për prodhim të energjisë nga burime të ripërtrishme. Ndërsa 150 MW të tjerë do të jenë në lloje me nga 75 MW gjatë vitit 2024. Gjithashtu, me strategjinë 2022 – 2031 Qeveria synon t'i shtojë 1200 MW prodhim të energjisë elektrike nëpërmjet burimeve të ripërtrishme.

Tutje, ai tha se synim është që Kosova të bëhet destinacion i dëshiruar për prodhim të automjeteve elektrike, duke importuar vetëm lëndën e parë, e pastaj duke e eksportuar si produkt final, për shkak të fuqisë punëtore dinamike dhe me kosto konkurruese. Shprehi përkushtimin për të formuar një platformë të fortë për dialogun publiko-privat që mundëson identifikimin e mundësive dhe adresimin efikas të sfidave.

Qeveria në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat, asociacionet e bizneseve dhe partnerët ndërkombëtarë, së bashku me Shefin e Stafit, Luan Dalipi, ka formuar një plan vjetor ambicioz për vitin 2024, e që është mbështetur nga Sekretariati i Pavarur i Këshillit i financuar nga SECO zviceran, e i menaxhuar nga BERZH në Kosovë. Ky plan nxit investime dhe eksporte dhe për të thelluar dialogun mes qeverisë dhe sektorit privat.

**Luan Dalipi, Shef i Stafit të Kryeministrit**, shprehu falenderimin për bashkëpunim me 16 asociacione të bizneseve në vitin 2023, si dhe dikastere të tjera qeveritare që janë relevante.

Poashtu, theksoi se qasja e Qeverisë për bashkëpunim në relacionin Qeveri-sektor privat ka qenë e bazuar në tri fjalë, e ato janë: vlerat, sistemet dhe rezultatet. Vlerat që Qeveria i çmon shumë janë: komunikimi, bashkëpunimi dhe bashkërendimi me asociacionet bilaterale e sektoriale në Kosovë. Për fund, ai shtoi se ka bashkëpunuar me Sekretariatit e KKEI për definimin e një kalendari për tërë vitin 2024 dhe vitet e ardhshme të dialogimit publiko-privat, i cili tashmë është ndarë me pjesëmarrësit.

## **Përmbledhja e diskutimeve kryesore**

**Zëvendësministër Hysen Durmishi, MMPHI**, lidhur me projektet aktuale të MMPHI-së të cilat i kontribuojnë mjedisit të të bërit biznes në Kosovë, listoi ndër të tjera:

- Miratimin e strategjisë së sistemit inteligjent të transportit që do të adresojë sfidat aktuale të sektorit të transportit në Kosovë, e cila do të mundësojë integrimin e sistemit të TIK në trafik rrugor, për të arritur manaxhimin më të avancuar të trafikut, mobilitetit dhe incidenteve në trafik;
- Në bashkëpunim me ASHI, lancimin e projektit lidhur me aplikimin dhe ndarjen e termineve për provimet teorike dhe praktike për patent shofer, që kontribuon në transparencë në këtë fushë;
- Realizimi i pagesave në mënyrë digjitale përmes platformës e-Kosova;
- Zhbllokimi i projektit të rrugës Prishtinë-Mitrovicë, ku është nënshkruar kontrata për këtë projekt. Punimet për këtë projekt kanë filluar në kohën e mbajtjes së takimit;
- Fillimin e punimeve në rrugën Prishtinë-Podujëvë dhe Prishtinë-Gjilan;
- Në rrugët Kijeve-Dollc dhe Gadov-Zahaq do të fillojnë punimet shpejt;

- Përgatitjen e dokumentacionit teknik për të filluar punën në segmentin Bresalc-Dheu i Bardhë;
- Përgatitjen e aplikacionit për asistencë teknike për hartimin e projektit kryesor dhe azhurnimin studimit të fizibilitetit për autostradën Durë-Banullë që lidh të gjitha autostradat në Kosovë dhe lehtëson qarkullimin e automjeteve dhe të mallrave.

Duke folur në emër të MMPHI, Zëvendësministri Durmishi shprehu përkushtimin për të investuar në projekte kombëtare, sic është modernizimi i rrugëve dhe hekurudhave. Jemi dakorduar mes dy shteteve që të bisedojmë për trasenë se kah do të kalojë hekurudha që do të lidh Kosovën me Shqipërinë. Punimet intensive për Hekurudhën Prishtinë-Durrës, si një projekt i madh infrastrukturor do të fillojnë pas përfundimit të procesit të studimit të fizibilitetit.

Sa i përket Rrugës Prizren-Tetovë është nënshkruar marrëveshja për bashkefinansim për hartimin e projektit kryesor për ndërtimin e tunelit për këtë rrugë që është korridor i rëndësishëm për tansportin rajonal.

Ndërkaq, si zhvillim tejet i rëndësishëm në fushën e aviacionit, është bërë hapja e korridoreve ajrore me Republikën e Shqipërisë. Kjo e bën Kosovën më konkurruese në raport me vendet e tjera në rajon. Ulja e kostove të fluturimit nuk ndikon vetëm në uljen e shpenzimeve e linjave ajrore, por gjithashtu kontribuon në uljen e emitimit të gazrave.

Për fund, Zëvendësministri Durmishi deklaroi përkushtimin e Qeverisë për një infrastrukturë të fuqishme dhe efikase, duke i dhënë prioritet projekteve të transportit dhe infrastrukturës drejt përmisimit të standardit të jetës së qytetarëve të Kosovës.

**Zëvendësministër Getoar Mjeku, ME**, theksoi së janë duke e plotësuar strategjinë me një ligj të ri për promovimin dhe përdorimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë. Element kryesor është caktimi i një caku të detyrueshëm kombëtar e shtetëror për pjesën e energjisë nga burime të ripërtrishme në që pjesë e bruto konsumit final për vitin 2030.

Po nxisim konsumatorët të prodhojnë, të ruajnë dhe shesin tepricën e energjisë elektrike në BRE, po vendosim parimet bazë për qasje në rrjet dhe po rregullojmë lëshimin e garancive të prejardhjes së enrgjisë nga BRE.

Ligji i ri dhe ndryshimet e fundit në legjislacion hapin rrugë për të ngritur pragun e kapacitetit të prodhimit, po qartësohen kriteret për autorizim për konsumatorët që të prodhojnë energji elektrike. Në këtë drejtim, ligji do të mundësojë:

- Vendosjen e kriterëve dhe kushteve për instalimin e pajisjeve;
- Zbatimi i skemës së faturimit neto për konsumatorët vetanak;
- Vendosja e pragut për kualifikimin për skemë mbështetëse për konsumatorët si dhe metoldogjinë për përcaktimin e vlerës monetare që rishikohet cdo dy vjet;
- Instalimin e teknologjisë së ripërtrishme në ndërtesa shumëbanesore, duke ua mundësuar banorëve të ndërtesave të prodhojnë energji elektrike për konsum vetanak, e më pas mundësinë që ta shesin, apo ta ndajnë mes vete;
- Thjeshtësimin e procedurave për prodhim me kapacitet deri në 50KW dhe afat të shkurtuar të lejes për kyçe në 30 ditë. Kjo zvogëlon barrën administrative ndaj prodhuesve, shërben si incentivë në përdorimin e energjisë së ripërtrishme.

Më ndryshimin e aktit përkatës nënligjor, do t'u mundësohet konsumatorëve vetanake të vëndosin në çati panele solare fotovoltaike me kapacitet deri në 7 kW të mos kenë nevojë të pajisen me leje ndërtimore.

Zëvendësministri informoi se Rregullatori përcakton kriteret e nevojshme për instalimin e stabilimenteve të vet konsumatorëve në ndërtesa duke i përfshi edhe komplekset shumëbanesore.

Përparësitë e këtij ligji përfshin obligimin e operatorëve të rrjetit të jenë të hapur për t'u mundësuar kycje prodhuesve që përdorin burimet e ripërtrishme, dhe konsumatorëve vetanak.

Në këtë drejtim, vlen të theksohet thirrja për përkrahjen e ndërrmarjeve të mikro, të vogla dhe të mesme me një buxhet prej 5 milion euro, ku përfshihet përkrahja për instalimin e mjeteve ngrohëse, instalimin e sistemeve diellore fotovoltaike për vetëkonsum si dhe instalimin e sistemeve diellore për ngrohjen e ujit sanitarë.

Është përmblye faza e parë e përzgjedhjes që përmes një kompanie që përmes një ankandi përmes një skeme konkurruese ku do të ndërrohet parku I parë solar me kapacitet 100 MW. Do t'i sjellë Kosovës 950MW kapacitete gjeneruese dhe akumuluese në vlerë prej 1, 2 miliard euro.

Zëvendësministri Mjeku ftoi pjesëmarrësit të drejtohen në webfaqen [www.resksovo.rks.gov.net](http://www.resksovo.rks.gov.net) për të gjitha projektet aktuale që lidhen me energjinë e ripërtrishme. Ndër të tjera, kjo webfaqe përfshin edhe hartën me kapacitet për energji nga dielli dhe era, si dhe projektet afatmesme.

**Sergiy Maslichenko, BERZH**, theksoi se në vitin 2023 BERZH ka nënshkruar 16 projekte, në vlerë 18 milion euro, 15 prej të cilëve kanë qënë në sektorin privat dhe një në sektorin publik.

Drejtori Maslichenko u shpreh se rëndësia e sektorit privat është e shumëfishtë, krijon lidhje, ndihmon në integrimin e Kosovës në tregun evropian, në valutën këmbimore, u ndihmon bizneseve në lëvizjen e shërbimeve dhe mallrave, edhe të qytetarëve, krijon vende pune, mundësi biznesi për kompanitë e vogla. Investimet në hekurudha, në rrugë dhe shërbime komunale ndihmojnë në zhvillimin e ekonomisë.

Poashtu, z. Maslichenko informoi se është planifikuar nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit me kryeministrin Kurti në Samitin e Ballkanit Perendimor, që si target ka investimin në sektorin e infrastrukturës në vlerë prej 400 milion euro për tre vitet e ardhshme.

Prioritetet e BERZH janë: tranzicioni në energji të gjelbër është prioritet shumë i rëndësishëm. Kososva tashmë ka në sektorin privat projekte me energji të erës prej 140MW. Ka pasur investim direkt që është realizuar pesë vjet më parë në vlerë prej 250 milion eurove. Kompanitë vendore kanë shprehur interesim që të ndërtojnë panele solare të vogla me kapacitet prodhimi 20MW po ashtu edhe ato më të mëdhaja me kapacitet prodhimi prej 100MW. Këto kompani po hasin në vështirësi shkakut i vonësive të energjisë së ripërtrishme, hapësirës shkakut i barrierave rregullative, e që duhet të rregullohet kjo ceshtje.

Ankandi është instrument i mirë por nuk është zgjidhje për gjithcka, ka edhe mënyra të tjera konkurruese me cmime të mira dhe ka zhvillues përreth për cka BERZH është e gatshme të ndihmoj Qeverinë që ta përmisoj legjisllacionin për këto projekte të sektorit privat. Duhet

marrë shembull Shqipërinë, e cila gjatë 4 viteve, përmes ndihmës së BERZH-it ka zhvilluar ankand solar për 800MW.

Ministria duhet të intensifikojë angazhimin në këtë sferë. Qeveria duhet të shpallë edhe një tjetër rund të ankandit sa më shpejtë që është e mundur, gjë për të cilën EBRD është e gatshme të ofrojë asistencë teknike dhe atë financiare.

Sa i përket transportit, z. Maslichenko shpreh zhgënjimin me punimet për rrugën lidhëse të Gjilanit me atë të Fërizajt, sepse ka qenë projekt madhor, e që është rishqyrtuar dhe është shtyre për 2- 3 vjet. Projekti tjetër i BERZH si grant ka qenë rruga Prishtinë –Podujevë në vlerë prej 18 milion e që është anuluar. Po ashtu, rruga Kijevë-Zahaq është anuluar. Jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me partnerët tanë dhe me donatorët dhe BE-në për të plotësuar këto projekte përmes financimit të donatorëve.

Sa i përket hekurudhave, shprehet i kënaqur me progresin e hekurudhës 10, po ashtu i kënaqur dhe i nderuar që kanë hapur tunelin vitin a kaluar bashkë me kryeministrin Kurti dhe uroi që ky projekt të përfundoj nëse jo këtë vit atëherë vitin e ardhshëm. Përsëri, EBRD shpreh gatishmërinë që ta ndihmojë Qeverinë edhe rrugët lidhëse të Prishtinës me Pejën e pastaj në Shqipëri që është e rëndësishme në aspektin strategjik.

Në lidhje me shërbimet, impianti i trajtimit të ujërave të zeza, transporti publik, po ashtu rrethrotullimin në Prishtinë për cka kemi shpenzuar 1 milion euro për përgatitje që është shumë e rëndësishme të vazhdohet tutje. Vitin e kaluar iu kemi komunikuar 15 projekte Ministrisë së Ekonomisë atë të Infrastukturës dhe minsitrive tjera relevante.

**Lulzim Rafuna, OEK**, theksoi rëndësinë e dialogut publiko-privat dhe gadishmërinë e bashkëpunimit mes sektorit privat dhe qeverisë për një zhvillim ekonomik dhe ngritjen e mirëqenies së qytetarit. Shprehu kërkesën për një kornizë legjislative më të kompletuar dhe kualitative. Ndër të tjera, z. Rafuna shprehu nevojën për reformimin e politikave fiskale sepse ka nevojë që lënda e parë të lirohet nga tatimet doganore, gjysmë produkte që ndikojnë direkt në procesin e prodhimit të lirohen prej tatimit të vlerës së shtuar. Vlen të rishikohet tatimi i vlerës së shtuar, që të zbrësë nga shkalla 18, në shkallën 8 përqind. Kërkoj që të rritet lobimi me qëllim të rritjes së investimeve të huaja, duke marrë shembullin e Kroacisë, ku, përmes Odës Ekonomike shtetërore, sektori privat avokon për tërheqjen e investimeve të huaja. Z. Rafuna shpjegoi se Oda Ekonomike e Federatës Austriake i ka ofruar OEK ndihmë për hartimin e memorandumit të bashkëpunimit, që flet për rëndësinë e bashkëpunimit me Ministrinë e Punëve të Jashtme. Po ashtu, kërkoj nga Qeveria që t'i ndihmojë OEK për eliminimin e disa pengesave të cilat hasen kur prodhimet vendore eksportohen.

**Arian Zeka, AmCham në Kosovë**, theksoi rëndësinë e dialogut Publiko-Privat. Kërkon që të nxirret Ligji përkatës për Kallot, Humbjet, Vjedhjet e Dëmtimet. Në këtë drejtim, njoftoi se Oda Ekonomike Amerikane ka propozuar dy opsione alternative në vitin 2015, andaj propozon që këto të rishikohen. Këto opsione përfshijnë, 1) nxjerrjen e një akti nënligjor në kuadër të Kodit Doganor dhe të Akcizave, apo 2) të nxirret një ligj i vecantë për këtë çështje, alternative kjo të cilën e preferoi AmCham.

**Nora Hasani, OEGJK**, shpreh se OEGJK ka dërguar një dokument përmbledhës me rekomandime që burojnë nga kllasterët, që kërkon përgjigje më të shpejtë nga Sekretariati i KKEI, por edhe nga z. Dalipi, (Shef i Stafit të Kryeministrit) sa i përket rekomandimeve nga sektori privat. Ajo shtoi se edukimi dhe aftësimi profesional është i rëndësishëm e që duhen hapa më të shpejtë në implementimin e sistemit dual për sektorë të ndryshëm. Ajo shpreson

që sa më shpejtë të vazhdohet përpara me Ligjin për Investime të Qëndrueshme, duke qenë se tani Kosova është në momentum për të tërhequr investime strategjike. Kjo ndihmon në tërheqjen e investitorëve në sektorët e prodhimit dhe sektorin e energjisë së ripërtrishme. Më tej, theksoi nevojën që Kosova të ketë top-level domain dhe IP adresë, që janë të rëndësishme për t'u mbrojtur nga sulmet kibernetike. Prandaj, u shpreh se Kosovës i duhet më shumë diplomaci ekonomike.

Me rastin e 10 vjetorit të procesit të Berlinit, znj. Hasani u shpreh se përmes KKEI, OEGJK do t'i adresojë ato çështje edhe përtej samitit.

**Emrush Ujkani, KIE,** kërkoi që të punohet më tepër që agjenda evropiane të ecë përpara. Ofroi ndihmën për Qeverinë në këtë aspekt. Kërkoi që të gjitha odat ekonomike por edhe përfaqësues të Qeverisë të marrin pjesë në konferencën e energjisë së qëndrueshme evropiane.

**Linda Shala, Dhoma Ekonomike e Grave G7,** kërkoi amandamentimin, ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Punës, sepse ka disa kategori që do të krijonin parakushte më të mira për pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe në ekonominë e vendit, por edhe amandamentimet të cilat janë të nevojshme për modernizimin e Ligjit dhe adaptimit me kohërat moderne. Edhe pse ka 6-7 vjet që po kërkojmë që ky ligj të amandamentohet nuk është përfshirë në planin legjislativ të vitit 2024.

**Artan Mehmeti, Sekretariati i KKEI,** kërkoi që të fillojnë të bisedojnë edhe për rekomandimet nga forumet sektoriale ku theksoi së janë mbajtur 10 sosh në vitin 2023.

Ndër të tjera, z. Mehmeti përmendi tri brenga të sektorit privat të ndërlidhura me Ligjin për TVSH, ku u përmendën: largimi i TVSH-së 8% në kontratat e prokurimit publik në fushën e shëndetësisë, largimin e TVSH-së në eksport të shërbimeve të transportit, me qëllim që të rritet konkurrueshmëria me rajon; si dhe largimin e TVSH-së për arin e pastër që shitet, ashtu që të tatóhet vetëm puna e dorës e shtuar.

Për çështjet e sektorit të energjisë, z. Mehmeti shprehu shqetësimet e sektorit privat lidhur me liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, i cili mund të shkaktojë rritje të dukshme të çmimeve. Sektori privat ka kërkuar që të gjendet një strategji apo mënyrë që liberalizimi ose të vonohet, ose të gjendet një metodë alternative që të mos rritet cmimi në mënyrë drastike. Shqetësim tjetër ishte kërkesa për marrje të autorizimit nga ZRRE, dhe trajtimi i këtyre kërkesave brenda 30 ditësh nga ZRRE.

Në lidhje me këtë, ai theksoi kërkesën e prodhuesve që të rritet limiti 200KW për instalimin e paneleve solarë për kompanitë prodhuese që kycen në tension të mesëm.

Për me tepër, që një kohë, prodhuesit nuk e kanë të mundur të blejnë thëngjillin nga Kosova Thëngjill, por po obligohen që thëngjillin ta marrin nga Serbia më cmim të dyfishtë, përderisa nuk e dinë arsyen e kësaj mungese.

**Albin Kurti, Kryeministër i Kosovës,** theksoi edhe njëherë së Qeveria ka vullnet dhe interesim që ta vendosin Kosovën në hartën e investimeve dhe zgjerimeve strategjike të korporatavë të huaja. Ministria e Punëve të Jashtme dhe ajo e Diasporës do të bëhen agjenci e fuqishmëe e cila e forcon diplomacinë ekonomike. Theksoi tutje që janë duke u bërë reforma të brendshme, ndër të tjera, krijimi i Agjencisë për Investime dhe Eksport, si dhe një lloj i dinamizimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme në këtë aspekt. Rritja e bizneseve të Kosovës

do të shkojë paralelisht me hulumtimin e tregjeve të jashtme, pasi që ekziston interesi që bizneset e Kosovës të eksportojnë sa më shumë, marrë parasysh potencialin e tyre. BQK, ATK, ZRrE, bizneset përmes shoqatave të tyre, e Qeveria, edhe pse janë të ndryshme, kanë qëllime të përbashkëta.

Kryeministri Kurti tregoi për interesimin e Qeverisë në rritjen e pagave në sektor privat, të ketë siguri në punë, ngritje e aftësim në karrierë, rritje të mirëqenies sociale. Kryeministri kërkoi që, përmes dialogut publiko-privat të kuptojë më mirë se çfarë mund të bëhet në këtë drejtim, duke qenë i vetëdijshëm për disa nga vështirësitë që hasin bizneset. Ai theksoi se faktori njeri është shumë i rëndësishëm, prandaj edhe Qeveria është e gatshme të përkushtohet në rritjen e pagës së sektorit privat. Ai shtoi, krahas sektorit të energjisë, marrjen e kredive nga punëtorët, do të punohet edhe drejt rritjes së pagës mesatare, duke qenë se kjo ndihmon indirekt edhe tek sektori publik.

**Lulzim Rafuna, OEK**, propozoi të reformohet legjislacioni i tatimit të vlerës së shtuar, pasi që i njejtë i takon konsumatorit dhe jo i ndërmarrjes, ashtu që të bëhet shtyrja e inkasimit. Kjo do të ndihmonte bizneset duke krijuar mundësi për krijimin e likuiditetit, dhe mundësi për zgjerimin e biznesit. Për më tepër, ai tha se kjo do të kursente bizneset nga nevoja për huamarrje. Në këtë aspekt, ai propozoi që të zbatohen faza, ashtu që të jenë 60 ditë kohë për inkasim të tatimit të vlerës së shtuar. Kjo do të ishte reformë shumë e volitshme, e cila do ta bënte ambientin biznesor më atraktiv dhe më të favorshëm për investitorët e huaj.

**Nora Hasani, OEGJK**, kërkoi sqarim për mospërfshirjen e Ligjit të ri të Punës në program legjislativ për vitin 2024.

**Ministre Rozeta Hajdari, MINT**, u shpreh se plani legjislativ për vitin 2024 përditësohet kohë pas kohë, të cilin edhe Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve e shqyrton në kohën e duhur.

**Artan Mehmeti, Sekretariati i KKEI**, në emër të Sekretariatit, ofroi gatishmërinë dhe ndihmë në shqyrtimin e këtyre çështjeve, apo edhe realizimin e një studimi fizibiliteti, në mënyrë që të nxjerët një rekomandim sipas diskutimit në takim. Z. Mehmeti njoftoi se sapo të caktohen çështjet për diskutim, ato do të çohen përpara përmes Sekretariatit.

**Arjeta Pozhegu, SHPDK**, shprehi shqetësimin për vështirësitë për transportin e mallrave nga Kosova në vendet e BE-së, si pasojë e prezencës së kamioneve me targa të huaja të Serbisë dhe të Bosnjës. Po ashtu, znj. Pozhegu kërkoi që kjo çështje të rregullohet përmes institucioneve që janë përgjegjëse, ashtu që të ketë lehtësira në transport. Ajo theksoi nevojën për shpejtimin e punës së shpedicioneve, duke larguar barrierat administrative, e për këtë mori shembullin e Suedisë. Tutje, ajo njoftoi për nevojën për subvencionim të eksportit dhe krijimin e një agjencioni të eksportit. Po ashtu kërkoi lirim nga taksat dhe detyrimet e punëtorëve, të investitorëve vendor dhe të huaj për dy vitet e para të punës, sidomos kur janë ndërmarrje start-up.

**Vjollca Cavolli, STIKK**, theksoi mungesën e implementimit të strategjive, si psh strategjia e digjitalizimit të arsimit, e cila është shumë e rëndësishme për Kosovën dhe zhvillimin e njohurive. Ajo tha se numri i 200 shërbimeve digjitale që ofrohen në e-Kosova aktualisht duhet të rritet shumë, duke bërë krahasimin me 2000 shërbimet që ofron platforma ekuivalente në Shqipëri. Znj. Çavolli i bën thirrje Qeverisë që të aplikojë sistemet e mençura për përdorim e energjisë së ripërtrishme nëpër institucionet e Qeverisë.

**Artan Mehmeti, Sekretariati i KKEI,** pyeti nëse ndokush nga të pranishmit ka interesim të diskutojë për çështjen e 7KW dhe pyet rreth mundësisë që kjo kërkesë të mos kalojë përmes ZRRE-së.

**Ymer Fejzullahu, ZRrE,** theksoi se nuk nevojitet leje ndërtimore as për bizneset e as për konsumatorët shtëpiak që instalojnë deri në 7 kW, falë bashkëpunimit me Qeverinë. Mirëpo ende ekziston në ligj që kërkon autorizim nga ZRrE-ja për cdo kilovat që kycet në rrjet, për cka edhe kërkohet nga rregulli të aplikohet për autorizim, e që mërr kohë deri në 30 ditë për lëshim të autorizimit. Ai shtoi tutje se, sipas kërkesës së bizneseve është rishikuar rregulli dhe kanë shkurtuar afatin nga 90 ditë në 30 ditë për aplikimet e prosumatorëve. ZRrE e mbështet propozimin që të mos ketë nevojë për lëshim të autorizimit për konsumatorë shtëpiak, e sidomos për konsumator biznesor të vegjël. Ai theksoi se shpreson që kjo çështje të adresohet në ligj për burimet e ripërtrishme.

Në lidhje me çështjen e 200 eneeKW, kufizimi është vërtet për ata që furnizohen me tarifa të rregulluara, kurse për konsumatorët që furnizohen me tarifa të tregut ose me cmimet e tregut, nuk vlen ky limit. Ai tutje tha se konsumatorët të cilët shohin interes të lëvizin me cmime të tregut mund të instalojnë panele solarë në bazë të kapacitetit që ata posedojnë ose e kanë nga ana OSSH-së. Nuk ka kufizime për konsumatorët që furnizohen me tarifa të parregulluara dhe ky kufizim aplikohet vetëm për konsumatorët që furnizohen me tarifa të rregulluara. Në kufizimin për 200 kW janë të përfshira 90 përqind e bizneseve. Është aprovuar metodologjia për taksën e kycjes, e që ka parapa lehtësira që nuk janë para me UA të vitit 2005 që ka qenë në kuadër të UNMIK-ut.

**Anyla Beqa, ME,** theksoi se inputet nga sektori privat janë shtysë për Ministrinë e Ekonomisë që të punojnë në tranzicionin energjetik në Kosovë, gjë që është edhe pjesë e strategjisë së tyre. Znj. Beqa tha se, ME, në planin e vet legjislativ përfshin komplet rishikimin e pakos së energjisë, ku bën pjesë Ligji për Energji, Ligji për Energji Elektrike, Ligji për Burime të Ripërtrishme, Ligji për Eficiencë të Energjisë, Ligji për ZRRE-në. Prioritet i ME-së është promovimi i Ligjit për Burimet e ripërtrishme si dhe Ligjit për Energji Elektrike, për të mundësuar lehtësira për integrimin e burimeve të ripërtrishme në sistemin elektroenergjetik si dhe mundësimin e integritit të sistemeve me bateri.

Për objektivat kryesore që parasheh ligji i ri, ajo tha se konsumatorët që bëjnë instalime për vetprodhim të kapacitetit deri në 1MW nuk do të kenë nevojë për autorizim, por mjafton ta njoftojnë ZRrE-në brenda një afati të caktuar. Konsumatorët në banesa shumëbanesore do të kenë të drejtë të prodhojnë energji të ripërtrishme për konsum vetanak, ku do t'u lejohet të organizojnë ndarje mes vete të energjisë nga burimet e ripërtrishme që prodhohen në lokacion të tyre apo lokacion të përbashkët. Rregullatori është ai që përcakton kriteret e nevojshme për instalimin e stabilimenteve. Ligji parasheh se operatorët e rrjetit obligohen të ndërrmarrin hapat e duhur për të lejuar qasje dhe për të krijuar kushte të duhura për kycje në rrjet për kapacitet deri në 50KW. Për këtë implementohet procedurë e thjeshtuar e kycjes në rrjet, ku obligohet operatori i sistemit të shpërndarjes brenda periudhës prej 30 ditëve të refuzojë ose aprovojë kycjen në rrjet.

Në lidhje me liberalizimin apo hapjen e tregut, znj. Beqa tha se ka buruar si rezultat i detyrimeve që i kanë nga Komuniteti i Traktatit të Energjisë, i cili daton nga viti 2005 e që është bartur në ligjet e Kosovës. Ajo shtoi tutje se janë duke punuar në identifikimin e



barrierave të tregut të energjisë që pamundësojnë një hapje të tillë e që do të sjellte konkurrueshmëri, gjë e cila do të mundësonte edhe KEK-ut pjesëmarrje në treg.

Po ashtu theksoi se bashkimi i tregut kombëtar Kosovë-Shqipëri do t'i jepte likuiditet shtesë bursës energjetike shqiptare ALPEX, e që kjo mundëson transparencë mes çmimeve në tregun e shitjes me shumicë. Për fund, ajo shtoi se KOSTT së bashku me Shqipërinë duhet të bëjnë përgatitje për t'u bashkuar në tregun panvropian.

**Ymer Fejzullahu, ZRrE**, theksoi së duhet të ketë liberalizim të çmimit me pakicë, e jo vetëm me shumicë me çmime të parregulluara në ALPEX.

Të gjithë prodhuesit vendor dhe ndërkombëtar mund të tregtojnë në tregun me shumicë në ALPEX me çmime të parregulluara, mirëpo tendenca është që në të njëjtën kohë të ketë liberalizim edhe të çmimit me pakicë. Z. Fejzullahu bën thirrje për diskutim të përbashkët që është paraparë për këtë vit me odat ekonomike për të tejkaluar keqkuptimet që kanë ndodhur në vitin 2017. Ai thekson tutje për nevojën e krijimit të bursës shqiptare, që është parakusht për sjelljen e investimeve të reja në kuadër të burimeve të ripërtrishme. Shtoi tutje parakushtin e BERZH për financimin e këtyre investimeve është garantimi i blerjes së asaj energjie. Ai rikujtoi se është detyrim i institucioneve që në raport me BE-në tash e tutje të kalohet në çmime konkurruese përmes fitimit premium ose ankandeve. Po ashtu shtoi se me mbështetjen e USAID kanë nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit mes rregullatorëve, të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut respektivisht të katër DSO dhe katër ALPEX-vë, e që Kosova është udhëheqës i këtij grupi. Dhe për fund theksoi rëndësinë e përfshirjes së Kosovës në bursën greke *EnEx* që automatikisht Kosova i bashkohet tregut evropian.

**Arian Zeka, AmCham në Kosovë**, ndërlidhet me komentet e bëra nga znj. Beqa dhe z. Fejzullahu, si dhe ofron bashkpunim që të diskutojnë lidhur me keqkuptimet që kanë ndodhur mes bizneseve dhe ZRrE-së. Poashtu, ai kërkoi të diskutohet për kërkesën e bizneseve për liberalizimin e energjisë së tregut para se të ndodh liberalizimi i ardhshëm për licencim. Po ashtu i kërkon z. Fejzullahu që të diskutojnë me kompanitë e licencuara për furnizim dhe për të parë arsyen pse ato kompani nuk fillojnë me ofrimin dhe promovimin e shërbimeve të tyre tek të gjitha kompanitë.

**Ministre, Rozeta Hajdari, MINT**, shpreh nevojën për funksionimin e KKEI në nivel makro, si dhe rekomandon të reflektohen ndryshimet sipas këtij diskutimi në Rregullat e Punës së KKEI.

Këshilli Industrial, i themeluar sipas vendimit të qeverisë nr. 06/159 të datës 13 shtator 2023 ka për qëllim zhvillimin e dialogut mes Qeverisë dhe të sektorëve industrial privat, i cili ka për synim rritjen e transparencës në vendimmarrje publike, e në hartimin e rekomandimeve për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ministrja Hajdari rekomandon që puna e atij Këshilli mund të bashkëveprojë e koordinohet përmes KKEI-së. Kjo sepse secili sektor i ka këshillet e veta dhe mund t'i sjellë në këtë forum ku pastaj do të procedohen në Qeveri. Theksoi rëndësinë e zbatimit të KIESA-as. Kërkoi koordinim nga ministritë e tjera në nivel kombëtar, në tri objektiva kryesore, që janë ato të nivelit makro, në ekonominë digjitale qarkore dhe konkurruese, që të kontribuojë në treg gjithpërfshirës dhe në mjedis të pastër dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Tutje, ajo shtoi se janë në bashkëpunim me MASHTI dhe Komisionin Qeveritar për aftësim profesional në përputhje me nevojat e tregut. Pasataj theksoi se Oda Ekonomike ka rolin për të kontribuar në mësimin dual, ashtu që të përputhen

resurset njerëzore me kërkesat e tregut. Kërkoi asistencë në formë të inpueteve për ta ndihmuar Qeverinë.

Ministrja Hajdari njoftoi se Ligji për Tregtinë e Brendshme është në proces të finalizimit, derisa janë në pritje të finalizimit të pjesës së e-commerce. Poashtu, duke i kontribuar inovacionit dhe ndërmarrësisë, është duke u themeluar Fondi për Inovacion, si instrument kryesor për zhvillim të ekosistemit të inovacionit në koordinim të afërt me të gjithë akterët e tjerë.

**Nora Hasani, OEGJK**, u shpreh se Qeveria Gjermanisë ka kontraktuar një kompani konsulente qeveritare që kanë ekipin German Economic Team (GET) që këshillojnë Qeverinë e Kosovës në fusha të ndryshme. Shtoi tutje, se GET ka përpiluar një raport lidhur me pengesat aktuale për cka edhe ka propozuar zgjidhje e që ia ka prezantuar Qeverisë në qarqe të ngushta. Po ashtu, znj. Hasani shfrytëzoi rastin të njoftojë se drejtuesi i GET do të jetë në Kosovë në javën e dytë të muajit mars, me ç'rast i ftoi asociacionet e bizneseve por edhe institucionet relevante që të takohen dhe të diskutojnë në mënyrë të hapur për alternativat e propozuara nga GET. Ajo shtoi se rëndësia e kësaj fushe reflektohet në faktin se 200 milion euro në vitin dalin nga Kosova për shërbime konsulence për çështje të transportit.

Për fund, znj. Hasani theksoi rëndësinë e ekzistimit të një *top-level domain* të Kosovës, i cili i kontribon sigurisë kibernetike, gjë për të cilën propozon të vendoset si prioritet në agjendën e Qeverisë.

**Artan Mehmeti, Sekretariati i KKEI**, u shpreh se mund ta fasilitojnë këtë temë në forumet e ardhshme të Sekretariatit.

**Ramize Ramadani, BQK**, theksoi faktin se aryseja prapa mos-anëtarësimit të Kosovës në sistemin e kartonit të gjelbër dhe sistemit të byrove, është e natyrës politike. Pavarësisht se kjo çështje nuk është nën mandatin e BQK-së, por BQK-ja prapë është angazhuar në këtë çështje, me të gjitha institucionet qeveritare në mënyrë që të gjendet zgjidhje për shkak të peshës që ka kjo fushë në ekonominë e Kosovës në sektorin e sigurimeve.

Ajo shtoi, se si institucion kanë qenë në kontakt me GET lidhur me alternativat që ata kanë prezantuar në raportin e tyre e që janë shumë vështirë për t'u adresuar si p.sh. kartoni i gjelbër të lëshohet nga një vend tjetër për Kosovën, që është vështirë e implementueshme.

Duke treguar për angazhimin e BQK për këtë çështje, znj. Ramadani njofton për alternativat për të cilat po diskutohet në këtë drejtim, duke përmendur si opsion zgjerimin e marrëveshjeve bilaterale me vendet e BE-së, por që është e vështirë për t'u arritur. Për të ilustruar pengesën në këtë drejtim, ajo përmendi faktin se edhe pse ekzistojnë marrëveshjet bilaterale me rajonin - me Serbinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, për të gjitha (me përjashtim të Shqipërisë) kërkohet siguri shtesë.

Ajo tha se kërkohet angazhim më serioz mes BQK-së, insitucioneve qeveritare dhe Byrosë, në mënyrë që të adresohet kjo çështje dhe të jetë e suksesshme në mënyrë që të gjindet një zgjidhje e përkohshme derisa Kosova të jetë anëtare e plotë me të drejta të barabarta dhe të plota në Këshillin e Byrove. Vetëm me ndryshimin e statutit të Këshillit të Byrove mund të bëhet zgjidhje.

**Arjeta Pozhegu, ShPDSK**, kërkon të dijë për zgjidhjen se si do të bëhet lidhur me kartonin e gjelbër dhe Këshillin të Byrove në mënyrë që kamionët kosovarë të mos hasin në probleme kur të udhëtojnë jashtë Kosovës.

**Ramize Ramadani, BQK**, informoi se janë disa zgjidhje, por që janë shumë vështirë të implementueshme e me një angazhim më serioz dhe lobim mund të bëhet një zgjidhje e ndërmjetme.

**Arjeta Pozhegu, ShPDK**, u shpreh se ka qenë në procedurë përmes BSK-së dhe që është një pagesë që duhet bërë atje.

**Ramize Ramadani, BQK**, theksoi se pengesë nuk është aspekti monetarë dhe teknik, sepse ka patur ndryshime pozitive në këtë drejtim, por arsyeja e vetme zyrtare e Këshillit të Byrove është, se Kosova nuk është anëtare e OKB-së.

**Illir Murtezaj, ATK**, u shpreh se sipas të dhënave zyrtare ka rritje të formalizimit të tregut. Z. Murtezaj theksoi se me rritjen e ekonomisë rreth 10.7 përqind ka zbutje të informalitetit. Tutje, ai tha se, do të merren parasysh dhe do të diskutohen brenda ATK-së çështjet e ngritura në forumet sektoriale lidhur me ndryshimet në Ligjin për TVSH-në, si dhe mundësitë më të mira për t'u implementuar.

Lidhur me çështjen e ngritur nga shoqata e artarëve, z. Murtezaj shtoi se TVSH nuk është faktori i vetëm që ka çuar te informaliteti i skajshëm në këtë fushë, por se ndikojnë edhe faktorë tjerë. Ai tha se ATK është duke punuar në formalizimin e kësaj fushe.

Çështjen e TVSH-së lidhur me transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, ai e konsideroi valide, duke shpjeguar se ligji aktual për TVSH-në nuk e parasheh lirin nga TVSH-ja këtë kategori të të hyrave biznesore. Megjithatë, duke qenë se direktivat e BE-së e njohin një këtë lirim nga TVSH, ka hapësirë që kjo dispozitë të rishikohet me qëllim që ky sektor të jetë më konkurrues në treg. Ai tha se Ligji për TVSH është në plan legjislativ të Qeverisë.

Për fund, ai shprehi kënaqësinë për nivelin e digjitalizimit të shërbimeve të ATK-së, jo vetëm në fushën e biznesit, por edhe në procesin e deklarimit të pagesave të tatimeve.

**Artan Mehmeti, Sekretariati i KKEI**, u shpreh se si takimi i radhës i KKEI, i cili do të mbahet më 7 shkurt, do të jetë mundësi e mirë për të trajtuar më detajisht këto çështje e për të gjetë zgjidhje konkrete. Ligji për TVSH-në mund të jetë temë që diskutohet më në detaje.

**Agron Llugaliu, DK**, u shpreh i kënaqur me shtritjen e komunikimit të Doganës së Kosovës me komunitetin e biznesit, pasi që arritjet e Doganës kanë rezultuar nga inputet nga vetë komuniteti i biznesit. Si një nga këto arritje, z. Llugaliu listoi lirin e tri kategorive të produkteve që përdoren në prodhimtari, përfshirë të gjitha pjesët rezervë për makineritë që përdoren për prodhimtari, lirin për bicikleta, për pjesët rezervë të bicikletave, si dhe produktet që përdoren për paketim e nuk prodhohen si ambalazh në Kosovë. Kjo i ka vendosur prodhuesit vendorë në një pozitë më të favorshme.

Rreth çështjes së arit, ai njoftoi për politikën që zbaton Dogana e Kosovës, sipas të cilës ari konsiderohet si kapital, duke aplikuar taksë në kufi vetëm për pjesën e arit e cila përpunohet, jo edhe arin e pastër. Ai informoi se është njoftuar së fundi me problemin e bizneseve të kësaj industrie për sigurim me rast të transportit ndërkombëtar, në mungesë të një kompanie që kryen këtë shërbim. Kur bëhen përpunime jashtë vendit mund të bëhet përmes procedurave pa problem e që janë të liruar nga taksa.

55 përqind e dërgesave kanë kaluar përmes terminaleve që menaxhohen nga dogana që dmth këtyre dërgësa nëse flasim me terma të saktë, mbi 200 mijë dërgesa u është evituar pagesa që ka qenë më herët e aplikueshme me casje në terminal, e që ka qenë 40 euro.

Z. Llugaliu informoi për disa lehtësira dhe procese të vazhdueshme në të cilat është angazhuar Dogana e Kosovës së fundi:

- Zhdoganimi në portin e Durrësit që nga tetori 2022. Si rezultat i kësaj, afro 15 përqind e tregtisë sonë të jashtme zbatohet përmes kësaj linje të furnizimit përmes transportit detar. Kjo ka rezultuar në kursimin e 9 mln eurove në vit për bizneset kosovare që bëjnë tregti përmes kësaj linje. Pas angazhimit në këtë fushë, Shqipëria ka vendosur që, në bazë të vlerësimit të përbashkët, të evitohet një shtresë e kontrollit - Agjencioni Kombëtar i Ushqimeve që është për të gjithë mallrat që janë të destinuara për Kosovë. Poashtu, bartja e autoritetit tonë, që është Agjencioni i Veterinës, me bazë në Durrës, ka ndikuar në uljen e kostos dhe kohës së zhdoganimit.
- Përsheptimin e procesi i zhdoganimit, e sidomos në procedurat e eksportit, pavarësisht rritjes prej 13% të transaksioneve në kuadër të tregtisë së jashtme gjatë 2023. Duke e ilustruar me shifra, z. Llugaliu krahasoi kohën e zhdoganimit për 0-30 min për 89% të dërgesave sa ishin në vitin 2022, në 92% në vitin 2023, kjo si rezultat i të dhënave në sistemin elektronik. Ai tha se një dinamikë e ngjashme ka përcjellur edhe procedurat e importit.
- Evitimin e garancioneve bankare për bizneset të cilat bëjnë përpunimin e brendshëm (63 subjekte), duke rezultuar në vlerë të taksave pezullore prej 5 milionë
- Bashkëpunimin me Bankën Botërore për përgatitjen e një udhëzuesi për një *single window*. Kjo platformë synon vendosjen e të gjithë akterëve me regjim kontrolli në import-eksport, në një dirtare të vetme. Përveç se plotëson një kriter drejt integritit evropian, kjo e lehtëson mënyrën e komunikimit, menaxhimit të licencave, dhe regjimet e masave të tregtisë së jashtme.
- Leximin e parë të Kodit Doganor dhe të Akcizave në Parlament; pritet së shpejti të vazhdohet me leximin e dytë.
- Digjitalizimin e shërbimeve doganore, ku Dogana ka kohë që aplikon zhdoganimin pa letër. Megjithatë, Drejtori tregoi se shërbimet akoma nuk janë integruar në e-Kosova, derisa shpreson se deri në fund të vitit 2024 të vendosen 23 procese kryesore të komunikimit aty.
- Synimin që të punësohen 120 zyrtarëve të rinj në fillim të vitit për zgjerimin e kapaciteteve.
- Mundësinë e integritit të Intelejgjenës Artificiale për rritje të efikasitetit të shërbimeve.

Tutje, Drejtori i Doganës theksoi rëndësinë e të komunikuarit me bizneset përmes KKEI. Kjo për shkak se, ndër të tjera, do të ketë nevojë të përgatiten udhëzime të reja administrative në përputhje me Kodin e ri Doganor, gjë për të cilën do të duhen inpute nga komuniteti i biznesit, që t'i shërbehet sa më mirë interesave të tyre.

Për fund, z. Llugaliu shpjegoi rreth mundësive për:

- 1) Operatorit të autorizuar ekonomik
  - a. Për t'u cilësuar si operator i autorizuar ekonomik, kompanitë duhet t'i plotësojnë kushtet e caktuara me dokumentacionin përkatës, të cilat i mundësojnë benefite të shumta. Në të ardhmen, sidomos me procesin e integritit, ky proces që do të njihet në aspektin bilateral edhe më gjërë, duke

përfshirë vendet e CEFTA-s dhe ato të BE-së, e cila ofron më shumë lehtësira. Kjo lidhet edhe me temën e ngjitur më parë nga znj. Arjeta lidhur me problemin në të cilin kishin hasur në Suedi.

2) Eksportuesit të autorizuar, që funksionon nga viti 2022.

- a. Sipas këtij autorizimi, kompanitë pastaj nuk kanë nevojë të marrin certifikatë që dëshmon origjinën. Përmes një pasusi - standard i paraparë në vendet që e zbatojnë - e vëndosin në faturë një paragraf që e dëshmon se mallrat janë me origjinë nga Kosova. Secili vend pranues e ka mundësinë ta verifikojë këtë.

**Artan Mehmeti, Sekretariati KKEI**, shpreh gatishmërinë që t'i kontakojnë bizneset dhe institucionet për forumet që do të mbahen më 6-14 mars 2024 për të marrë pjesë në diskutime me sektorin privat, ashtu që të diskutohet rreth udhëzimeve që do të përpilohen në kuadër të Kodit të ri Doganor.

Tani fton pjesëmarrësit të shprehin pikëpamjet për legjislacionin për prokurim publik apo të japin ndonjë input për Rregullat e punës së KKEI.

**Vjollca Cavolli, STIKK**, i parashtron kërkesë z. Murtezaj (ATK) për të treguar përqindjen lidhur me rimbursimin e TVSH-së të kompanive të sektoreve të ndryshëm. Kjo propozon të trajtohet si çështje në takimin e radhës të KKEI-së.

Znj. Cavolli konsideroi se është e paqartë nëse pjesëmarrësit prezentë janë këshill inicues, themeltar apo anëtarë të plotë të Këshillit që duhet të votojnë Rregullat e punës momentalisht. Ajo shtoi se konsideron se pjesëmarrësit aktualë janë këshill themelues, përderisa nuk ekziston dokumenti që tregon se cilët janë anëtarët e rregullt të Këshillit. Ajo kërkoi shpjegim lidhur me këtë, për faktin se a ka kuptim të diskutohen Rregullat e punës në këtë takim.

**Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI**, u shpreh se ekziston vendimi që përbëhet prej disa pjesëmarrësve në takim, e që propozimi ka qenë që të shtohet si anëtar edhe entiteti që përfaqëson znj. Cavolli e disa të tjerë si anëtarë, e për cka pritet që ai vendim të votohet në takimin e radhës të Qeverisë. Inputet rreth Rregullave të punës merren nga znj. Cavolli e të pjesëmarrësit e tjerë tani, mirëpo votohet kur të ndryshohet vendimi.

**Luan Dalipi, Shef i Stafit të Kryeministrit**, duke rikujtuar se Sekretariati është strukturë e pavarur, sugjeroi që t'u jepen pjesëmarrësve një kohë e caktuar për komente dhe rekomandime rreth Rregullave të punës, për të cilën u pajtuan pjesëmarrësit.

**Nora Hasani, OEGJK**, pyet nëse anëtarët ekzistues sipas Vendimit ekzistues të Qeverisë do të barten edhe në Vendimin e radhës, apo duhet të aplikojnë sipas kriterëve, nëse votohen nga të tjerët, apo nëse Qeveria do të vendos se kush do të jetë.

**Artan Mehmeti, Sekretariati KKEI**, informoi se si shtesë ndaj anëtarëve në vendimin ekzistues janë edhe disa anëtarë që i ka propozuar Sekretariati, por në bazë të Rregullave votojnë të qe jane me vendim.

**Arjeta Pozhegu, SHPDK**, ngrit çështjen rreth nenit 2, pikës 4, sipas të cilës Rregullat janë të natyrës këshilluese. Poashtu, propozon që të modifikohet neni 8, ashtu që të largohet kërkesa që anëtarët e bordit të organizatës të mos kenë ndonjë procedurë të hapur ligjore, e kjo kërkesë të mbetet vetëm për drejtorin.

**Artan Mehmeti, Sekretariati KKEI**, theksoi se pasi u pajtuan me heret, komentet për këtë çështje do të mirepritën me shkrim.

**Osman Vishaj, KRrPP**, u shpreh se Ligji për Prokurimin Publik është ndër ligjet më të rëndësishme të Kosovës, duke qenë se shpenzohen paratë e taksapaguesve. Me këtë ligj u jepet hapësirë edhe ndërrmarjeve të vogla dhe të mesme, krejt cka duhet është të dizajnohet procesi i prokurimit e që mundëson vetëm zbatimin.

Tani e kemi mundësinë për të përpiluar një ligj të mirë, por edhe të marrim modele të rajonit. Unë e cmoj modelin kroat sepse e kemi një gjysmë tradite të parbashkët, është nivel i njejtë i njerëzve dhe nuk jemi ithtar të eksperimenteve.

Ai listoi disa çështje lidhur me draftin e ligjit të ri:

- Një prej gjërave për të cilat është punar në draft është tarifa e ankesave, që në vlerësimin që kemi bërë kemi propozuar është pak e madhe, e që është 100 mijë euro. Duke bërë krahasimin me Kroacinë, e cila e ka tarifën për ankesë rreth 60 mijë euro, ai propozoi që tarifa e ankesës sipas ligjit të ri të mos rritet deri në 100 mijë euro sepse është vlerë e madhe e që përbën rrezik potencial që kompanitë të hynë në marrëveshje mes veti.
- Modifikimi i kontratave, duhet të bëhet me direktivat të BE-së ashtu sic kanë thënë edhe Qeveria, por duhet të bëhet paralel me nivelin e zhvillimit që e ka vendi ynë. Nëse shkojmë me 50 përqind modifikim të kontratave, 99.9 përqind do të bëhet kontratë formale dhe do të modifikohet rrugës.
- Kontratat kornizë, sot janë tre vjecare pa mundësi vazhdimi. Nëse e lëmë me direktiva edhe planin e buxhetit dhe shpenzimeve është tre vjecar, kurse nëse lëmë katër vjet dhe me mundësi vazhdimi katër vjet, natyrisht se ekzistojnë arsyet se duhet të vazhdohet. Por ne kemi krjuar mundësi dhe arsyet që cdo kontratë në mënyrë figurative duhet të vazhdohet edhe për katër vjet.
- Lidhur me Bordin e OSHP, që ai e konsideron si themel dhe shtyllë, konsideron se duhet të ketë më shumë anëtarë. Numrin aktual është 5, mirëpo cdo herë kemi vakum institucional. Propozoj që në periudha të rregullta numri të jetë 9, por në periudha tranzitore duhet të rritet 12, 23 apo edhe 15, sepse nuk ka kosto të madhe dhe fuqia vendimarrëse shpërndahet në shumë njerëz.
- Rritja e ekspertëve në prokurim sot është duke u diskutuar në dy shkallë, por nuk funksion me dy shkallë. Qëllimi i organeve adminisitrative është shkurtimi i kohës së vendimarrjes. Duke iu referuar modelit të Kroacisë, ai thotë se duhet t'i jepet rëndësi ekspertëve. Tutje, tha se duhet të shkohet në përputhje me direktivat e BE-së, por të kihet parasysh rrethanat ekzistuese në Kosovë. Propozoi të kemi kujdes me Ligjin e Prokurimit Publik që të mos shfaqet nevoja ta ndërrojmë ligjin në të ardhmen e afërt në rast se është jofunksional, njëjtë si Kroacia.

**Vjollca Cavolli, STIKK**, shprehu indinjatën për procedurat e prokurimit publik dhe kërkoi që të shkurtohen ato, sepse sado që është shuma e vogël është e rëndësishme sepse është para publike, është para e taksapaguesve.

**Artan Mehmeti, Sekretariati KKEI**, theksoi se Sekretariati mund të përcjellë punën e draftimit të këtij ligji, si çështje shumë e rëndësishme e që kërkon një diskutim të gjerë. Për këtë, Sekretariati mund të fasilitojë takime rreth kësaj çështje. Z. Mehmeti i ftoi për të diskutuar më gjerë dhe më detajisht nëse pajtohen të gjithë pjesëmarrësit për këtë.

**Nora Hasani, OEGJK**, u shpreh se është mirë që të bashkërenditen aktivitetet sepse ZPS në kuadër të ZKM-së vitin e kaluar ka punuar në reduktimin e barrës administrative. Aty ka pasë fokus grupe të ndryshme, që tani mund të analizohen kur është fjala te prokurimi publik.

**Vedat Sagonjeva, ZPS**, u shpreh se janë duke punuar në këtë proces me ZKM-në, kurse programin për reduktimin e barrës administrative mbikëqyret prej zëvendëskryeministrit të parë z. Besnik Bislimi. Këtë program e mbështet Komisioni Evropian në bashkëpunim me Qeverinë Gjermane. Shtoi tutje se janë takuar me KRRPP-në dhe kanë kërkuar t'i mbështesin për digjitalizimin e disa procedurave, kështuqë janë në proces për të identifikuar shërbimet që mund të digjitalizohen dhe mund të largojnë barrat e ndryshme administrative për qytetarët dhe bizneset. Ai po ashtu kërkoi që në forumet e ardhshme të prezantohet se ku qëndrojnë dhe në cilat fusha është planifikuar të intervenohet për të reduktuar barrën administrative ose të kërkohet nga bizneset që t'i identifikojnë temat të cilat janë të rëndësishme për ta.

Diskutimi që është filluar me Odën Gjermane po vazhdon edhe me odat tjera që të shqyrtojmë mundësinë se si odat dhe bizneset të përfshihen dhe të kontribuojnë në zhvillim e politikave, në këtë format sic po bëhet edhe në KKEI.

**Ymer Fejzullahu, ZRRE**, kërkoi nga odat ekonomike dhe institucionet tjera që t'i dërgojnë komentet për ndryshimin e ligjit gjatë diskutimeve publike në mënyrë që të lehtësohen procedurat me ligj dhe jo të ndryshohen me akte nënligjore, sepse po shkakton vështirësi për ta në të ardhmën. Në lidhje me pragun prej 7 kW, ZRRE ka dërguar komente që të largohet kërkesa përkatëse në ligj.

**Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI**, theksoi se duhet të vendosen disa pika për të cilat Sekretariati duhet t'i përcjellë sidomos rreth ligjeve, e që për ligjin e punës duhet të diskutohet në forumin dhe takim e radhës të Këshillit që do të mbahet më 7 maj 2024, marrë parasyh rënëdhësinë e tij. Pastaj Ligji për kallot, humbjet, vjedhjet, Ligjin për Prokurimin Publik, Ligji për Energjinë nëse nuk kalon në Kuvend. Pastaj në takimin e radhës të kemi inpute konkrete se cka duhet të përfshihet në këto ligje. Kërkoi që inputet për Rregullat e Punës së KKEI të dërgohen pas dy jave nga kur dërgohen minutat e takimit.

**Luan Dalipi, Shef i Stafit të Kryeministrit**, u shpreh se pjesëmarrja e më shumë ministrive, si MFPT, MMPHI, ME, duhet të jetë më e madhe në takimet e Këshillit, në mënyrë që të përmirësohen takimet e tilla.

Tri fjalë kyçe janë të rëndësishme: bashkëpunimi, koordinimi dhe bashkërendimi, në mënyrë që të bashkëpunohet me kapacitete të plota dhe jo me rezerva. Metodologjia që e kemi ndërtuar së bashku, duhet të rishikohet edhe nga ju, pasi që vetëm identifikimi i saktë i problemit mund ta zgjidhë problemin. Aty duhet të futen edhe indikatorët kyc të performancës.

Z. Maslichenko më të drejtë i është ankuar Qeverisë për ngecje në disa procese në relacion me projekte të mëdha. Duhet të diskutohet rreth shkurtimeve te procedurave per projekte qe kane impakt madhor per vendin.

**Angazhimi i Sekretariatit të KKEI deri në takimin e radhës:**

- Konsultimi me sektorin privat në lidhje me draft-Ligjin për Prokurim Publik;
- Konsultimi me sektorin privat në lidhje me amandamentimin e Ligjit të Punës, si dhe futja e tij në program legjislativ të Qeverisë;
- Diskutim rreth nevojës për ndryshimet në Ligjin për TVSH.



## LISTA E PJESËMARRËSVE

### Përfaqësuesit nga Qeveria:

1. Kryeministri, kryesues;
2. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
3. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal;
4. Zëvendësministër i Ekonomisë;
5. Zëvendësministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
6. Shefi i Stafit të Kryeministrit;
7. Shefja e Kabinetit të Ministrisë së Ekonomisë;
8. Guvernatori i Bankës Qëndrore të Kosovës;
9. Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës;
10. Drejtori i Përgjithshëm i Doganës të Kosovës;

### Përfaqësuesit nga odat dhe shoqatat e bizneseve:

11. Drejtori Ekzekutiv i Odës Ekonomike të Kosovës;
12. Drejtori Ekzekutiv i Odës Ekonomikë Amerikanë në Kosovë;
13. Drejtorja Ekzekutive e Odës Ekonomike Gjermano – Kosovare;
14. Drejtori Ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropian;
15. Nënkryetarja e Dhomës Ekonomikë të Grave të Kosovës - G7;
16. Drejtorja Ekzekutive e Shoqatës së Përpunuesve të Drurit të Kosovës;
17. Drejtorja Ekzekutive e Asociacionit të Kosovës për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit (STIKK);
18. Drejtori Ekzekutiv i Kllasterit të Industrisë së Metalit dhe Energjisë së Ripëtrishme në Kosovë;

### Përfaqësuesit nga Ambasadat dhe misionet diplomatike:

19. Përfaqësues nga Ambasada Amerikane në Kosovë;
20. Përfaqësues nga Ambasada Gjermane
21. Ambasadori i Francës në Kosovë;
22. Përfaqësues nga Ambasada e Italisë;
23. Përfaqësues nga Ambasada e Turqisë;
24. Përfaqësues nga Ambasada e Holandës;

### Përfaqësuesit nga partnerët ndërkombëtarë:

25. Drejtori i Zyrës së Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në Kosovë (BERZH);
26. Udhëheqësi i programit të Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SECO);
27. Përfaqësues nga Banka Botërore në Kosovë (BB);
28. Udhëheqësi i programit të Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID);
29. Përfaqësues nga German Agency for International Cooperation (GIZ);

### Pjesëmarrësit jopermanent:

30. Kryetari i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë;
31. Kryetari i Bordit të Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik;
32. Përfaqësues nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
33. Përfaqësues shtesë nga BERZH;
34. Përfaqësues shtesë nga Zyra e Kryeministrit.

## SHKURTESAT E PËRDORURA

KKEI – Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime

OEK – Oda Ekonomike e Kosovës

OEGJK – Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

KIE – Këshilli i Investitorëve Evropianë

STIKK - Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës

SHPDK – Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës

ZKM – Zyra e Kryeministrit

ZPS – Zyra për Planifikim Strategjik

BQK – Banka Qëndrore e Kosovës

ATK – Administrata Tatimore e Kosovës

DK – Dogana e Kosovës

ZRRE – Zyra e Rregullatorit të Energjisë

KRPP – Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik

OSHP – Organi Shqyrtues i Prokurimit